



C.E.C GROUP sh.p.k

RAPORTI TEKNIK

***Sistemimi i Perroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit – Llixha dhe Rikualifikimi Urban i Zones.
Bashkia Diber***

1. Pershkrim i pergjithshem

Zhvillimi i vendit eshte i shoqeruar me ndryshime te medha ekonomiko - shoqerore, te cilat shprehen ne rradhe te pare me kerkesat ne rritje te transportit si ate nderkombetar ashtu dhe ate te brendshem. Tipar i transportit aktual eshte fleksibiliteti, individualiteti dhe kryerja e tij nga subjekte shtetere dhe private, tipike per nje ekonomi tregu te hapur e konkruuese, te cilat dalin ne dukje ne nje shkalle me te larte ne transportin rrugor, qe natyrshem ka prioritetin ne infrastrukturen e vendit.

Me kerkesen e Bashkise Diber ne kuader te zhvillimit te rajoneve dhe ne vazhdim te disa projekteve per Riprteritje Urbane ke dhene detyren e projektimit per objektin "Sistemim i perroit te llixhave , segmenti ura e pazarit – llixha dhe rikualifikim urban i zonës" si pjesa fundore por jo me pak e rendesishme e projektit do te synoje rehabilitimin e përroit te llixhave.

Ne kete projekt jane te parashikuara 3 nderhyrje:

1- Sistemimi i përroit te llixhave

Nderhyrja ka te beje me sistemimin e përroit te llixhave duke ndërtuar nje sistemim me mure gabioni përgjatë gjithë gjatësisë. Sistemimi i kanalit eshte krijuar ne dy zona ne lartësi te ndryshme bazuar dhe ne studimet hidrologjike per prurjet. Zona e pare me lartësi 3m perbehet nga nje mur gabioni te vazhduar dhe qe konturon nje kanal me gjerësi 8m. Zona e dyte eshte me lartësi 2m dhe eshte llogaritur qe per pjesën me te madhe te vitit te jete zone e shkelshme nga njerëzit pra te kete dhe rolin e nje zone rekreative pasi eshte menduar te jete e gjelbëruar.

2- Ndertimi i shëtitorës përgjatë përroit

Nderhyrja e dyte konsiston ne krijimin e nje shëtitorëje përgjatë përroit te llixhave. Kjo shëtitorë eshte projektuar me gjerësi 3m dhe eshte e parashikuar te jete e shtruar me pllaka guri. Pergjate shëtitorës eshte parashikuar te kete ndriçim. Pergjate gjithë shëtitorës eshte parashikuar te kete gjelbërim te larte.

3- Ndertimi i ambjenteve rekreative përgjatë shetitorës

Per te rritur sherbimin dhe favorizuar turizmin ne zone eshte konceptuar ndertimi i disa ambjenteve per tregtim te produkteve vendase dhe mobilimi urban përgjatë shëtitorës.

Pikat Kryesore per ne si Projektues kane qene:

- ☐ Evidentimin dhe marrjen ne konsiderate te gjithë rrjetit ekzistues infrastrukturor, si atij elektrik, rrjetit te kullimit te ujerave te shiut, tubat etj.
- ☐ Marrjen ne konsiderate te gjithë agjenteve atmosferike qe ndikojne ne zonen ku do te ndertohet objekti duke pasur parasysh qe objektet infrastrukture te kesaj zone kane nje ndikim te larte nga agjentet atmosferik.
- ☐ Realizimin e nje projekti estetik, ku behet kujdes ne perzgjedhjen e materialeve te ndertimit, ne menyre qe objekti te pershtatet me se miri per qellimin e ndertimit te tij

si dhe per funksionimin ne kete zone te mbrojtur per te shtuar numrin e turisteve dhe vizitoreve te shumte.

- ☐ Hartimin e vizatimeve te projektit konstruktiv dhe elektrik. Hartimin e detajeve per te gjithë elementet konstruktiv qe nevojiten.
- ☐ Hartimin e specifikimeve teknike per te gjithë zërat e punimeve pjese te preventivit.
- ☐ Hartimin i Preventivit te Punimeve ne perputhje me Vizatimet e Projektit, Manualet e Ndertimit dhe Studimet e Tregut dhe Specifikimet Teknike te Hartuara.

2. PLANIMETRIA E VENDNDODHJES SE PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Zona ne fjale eshte pjese integrale e kompleksit te llixhave. Ne gjendjen aktuale paraqitet e pa sistemuar dhe nje gjendje kaotike. Pergjate përroit ka materiale inerte te hedhura dhe mbeturina urbane. Mungesa e investimeve ne kete zone eshte kthyer ne pengese per zhvillimin e kesaj zone me potencial te larte zhvillimi. Ne prani te objektit qe eshte projektuar ndodhet kompleksi i llixhave te Peshkopise. Keto ujra termale jane te njohura per aftesite kurative te tyre si dhe per interesin qe kane pacientet per tu kuruar ne kete qender.



Kjo zone kufizohet nga rruga per ne kompleksin e llixhave ne anën veriore nga ura e qytetit ne anën perendimore dhe nga mali Greves.




Projekti fillon ne piken me koordinata $x=454635$ dhe $y=4614922$ ne sistemin koordinativ UTM WGS 84 dhe përfundon ne urën e qytetit me koordinata $x=453018$ dhe $y= 4614898$.

SKICAT DHE PLANIMETRIT E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE TE PROJEKTIT, SI DHE MENYRAT DHE METODAT QE DO TE PERDOREN PER NDERTIMIN E OBJEKTEVE DHE STRUKTURAVE


Ne kete projekt jane te parashikuara 3 nderhyrje kryesore:

1- Sistemimi i përroit te llixhave

Nderhyrja ka te beje me sistemimin e përroit te llixhave duke ndërtuar nje sistemim me mure gabioni përgjatë gjithë gjatësisë. Sistemimi i kanalit eshte krijuar ne dy zona ne lartësi te ndryshme bazuar dhe ne studimet hidrologjike per prurjet. Zona e pare me lartësi 3m perbehet nga nje mur gabioni te vazhduar dhe qe konturon nje kanal me gjerësi 8m. Zona e dyte eshte me lartësi 2m dhe eshte llogaritur qe per pjesën me te madhe te vitit te jete zone e shkelshme nga njerëzit pra te kete dhe rolin e nje zone rekreative pasi do te jete e gjelbëruar.



1.GJENDJA EKZISTUESE E PERROIT



2.NDERHYRJA NE SISTEMIMIN E PERROIT DHE KRIJIMI I SHETITORES




3.MANOVrimi ME BARRIERAT DHE HAPESIRAT

Sistemimi i përroit te llixhave

Ne planimetri shkalla e dyte e mbrojtjes lumore nuk ka gjeresi konstante kjo per te bere te mundur krijimin e zonave rekreative ne periudhen e frekuentimit te kompleksit te llixhave pranvere dhe vjeshte.

Ne afersi te perroit te llixhave eshte ndertuar nje shesh per ti dhene nje destinacion perfundimtar shetitores.




Sheshi ne afersi te kompleksit te llixhave

Pergjate shetitores eshte parashikuar dhe nje amfiteater per te bere te mundur organizimin e eventeve per frekuentuesit e llixhave.


2- Ndertimi i shëtitorës përgjatë përroit

Nderhyrja e dyte konsiston ne krijimin e nje shëtitorëje përgjatë përroit te llixhave. Kjo shëtitorë eshte projektuar me gjerësi 3m dhe eshte e parashikuar te jete e shtruar me pllaka guri. Pergjate shëtitorës eshte parashikuar te kete ndriçim. Pergjate gjithë shëtitorës eshte parashikuar te kete gjelbërim te larte. Ne zona te caktuara shetitorja nderpret perroit e llixhave. Ne keto zona jane parashikuar ura kembesoresh. Keto ura jane projektuar me skelet metalik. Mbeshtetja e konstruksionit metalik do te behet ne dy bazamente prej beton-armeje te realizuar me beton me pigment me ngjyre, kjo per ta bere sa me estetike. Gjithashtu Ura do te kete dhe nje solete te holle prej 10 cm e

cila do te shtrihet mbi konstruksionin e saje metalik. Betoni i Perdorur do te jete i Markes M-300MPa dhe hekuri i klases Feb-44k.




Paraqitje e seksioneve tip te rrugicave te shetitores



Paraqitje 3d e konstruksionit metalik te Urave tip te kembesoreve

Armimi i Soletes se Ures eshte bere me dopio zgare me diameter 12mm dhe me hap 12.5cm. Betoni i Perdorur per soleten do te jete i markes M-250MPa dhe hekuri i klases Feb-44k. Ne vizatimet e elementeve te mesiperm do te gjenden gjithashtu edhe shenimet teknike perkatese.Mbi Soleten e ures do te kemi shtresen e llacit dhe ate te pllakave te gurit. Elemente te tjere te urave tip do te jene edhe korimanot metalike si dhe veshja e struktures nga jasht me elemente druri Brise –Soleil vertikal 128x10x5.



Paraqitje e Mbeshtetjes se Ures dhe e armimit te soletes.




Paraqitje 3D e rrugizave dhe Urave te shetitores.

3- Ndertimi i ambjenteve rekreative përgjatë shetitores

Per te rritur sherbimin dhe favorizuar turizmin ne zone eshte konceptuar ndertimi i disa ambjenteve per tregtim te produkteve vendase dhe mobilimi urban përgjatë shetitores.

Ambientet per tregtimin e produkteve do te jene konstruksione te perkohshme te ndertuara nga elemente druri. Gjithashtu edhe elementet urban do te jene kryesisht prej elemente druri ku do te kete stola, kosha per mbeturinat , apo edhe vendqendrimet per frekuentuesit e kesaj shetitoreje.

Elementet e drurit jane parashikuar te luhen me boje per te rritur performancen e tyre ndaj faktoreve atmosferik apo agjenteve te ndryshem te cilet do te veprojne mbi keto elemente.



Paraqitje e ambienteve te perkohshem te tregtimit.

Keto objekte do te kene nje dhitrirje ne plan prej 5.1x20.8m dhe nje lartesi prej 4.5m. Elementet kryesor te konstruksionit do te jene kolonat e drurit me permasa 20x20cm, ndersa veshja do t realizohet me derrasa.





Pjese e mobilimit urban jane dhe stolat pergjate shetitores.

Ne fund te shetitores do te ndertohet edhe nje shesh I cili do ti jape edhe nje fund rrugicave. Ndertimi I sheshit do të konsistojë në këto pika:

1. Shtrimi i sheshit
2. Gjelbërimi
3. Mobilimi
4. Ndriçimi

Shtirimi I sheshit do të bëhet me pllaka guri me këto specifikime:

- Pllakë guri gëlqeror I prerë dhe i trajtuar me bocardim pikësor $\pm 2\text{mm}$, me përmasa $30 \times 30 \times 5\text{cm}$.
- Mënyra e shtrimit është si në figurë:



Në mungesë të të dhënave më specifike përzgjedhja e materialit bëhet nga arkitekti.


Në pjesët e specifikuara në projekt ku do të përdoren elementë të parapërgatitur betoni për kullimin e ujërave, do të përdoren element të tillë si në figurë:



- **Shtirimi i rrugices kryesore**

Shtirimi I sheshit do të bëhet me pllaka guri me këto specifikime:

- Pllakë guri gëlqeror i prerë dhe i trajtuar me bocardim pikësor $\pm 2\text{mm}$, me përmasa variabel dhe te crregullta.
- Mënyra e shtrimit është si në figurë:



- **Shtirimi i rrugicave dytesore**

Shtirimi I rrugicave dytesore do të bëhet me material **nidagravel** si në figurë.

Ky material përbehet nga rrjete plastike rigjidueuse si dhe nga mbushesi që është çakell.



Gjelbërimi

Gjelbërimi konsiston në shtrimin e sipërfaqeve të barit dhe në mbjelljen e pemëve. Sipërfaqjet e barit do të mbillen me tapet bari.

Pemët që do të mbillen janë:

- Geshtenja e Bute (Castanea Sativa Mill) me përmasatruku 15 – 20cm dhelartësi 5m.



- Meshtekna (Betula Alba) me përmasatruku 20 – 50cm dhelartësi 5m.



- Shelgu (Betula Pendula) me përmasatruku 20 – 50cm dhelartësi 5m



- Pise Mesdhetare (Pinus Nigra) me përmasatruku 15 – 20cm dhelartësi 5 m.



- Bredhi i Bardhe (Abies Alba) me përmasatruku 15 – 20cm dhelartësi 5 m.




Vendosja e pemeve per gjelberim do te behet ne baze te planimetrise qe gjelberimit dhe ne perputhje me preventivin apo specifikimet e projektit.

Mobilimi urban

Mobilimi urban konsiston në përdorimin e tre lloje.

a- Lloji 1 – stol ithjeshtë me ndriçim të fshehur poshtë. (Stolat tek sheshi fundor)
Stolat janë të parafabrikuar prej betoni të armuar të punuar për t'u lënë në dukje dhe me spesorëdruri 4cm për t'u ulur. Në pjesën e poshtme është i pajisur me hapësirë për vendosjen e ndriçimit të fshehur.



b- Lloji 2 – stolat per zonat e Pic-Nic.

Stolat ne zonat e pic-nic perbehen nga dy ulese prej druri me permasa 30x30x150cm te ngritura 10 cm nga toka me ane ted y kembezave metalike, si dhe nga nje tavoline e parapergatitur beton-armeje me permasa 60x180cm dhe lartesi 75cm. Trashesia e betonit te jete 8 cm tek tavolina. Te tre keto elemente vendosen mbi nje bazament betony te varfer me permasa 200x200cm. (si ne figure)



c- Lloji 3 – stolat ne rrugicat dytesore

Stolat ne rrugicat dytesore perbehen nga dy elemnte mbajtes te parapergatitur betonarme me permasa 50x50x15cm si dhe nga ulese horizontale druri me permasa 12x12x120cm. (Si ne figure)



d- Lloji 4 – stol I thjeshtë me ndriçim të fshehur poshtë. (Stolat tek rrugica kryesore)
Stolat janë të parafabrikuar prej betoni të armuar të punuar për t'u lënë në dukje dhe me spesorëdruri 4cm për t'u ulur. Në pjesën e poshtme është I pajisur me hapësirë për vendosjen e ndriçimit të fshehur.



e- Lloji 5 – stola për lojërë tavoline
Stolat për lojërat e tavolines pozicionohen si në projekt dhe kanë permassa plane 250x250cm dhe janë komplet me konstruksion druri të vendosura mbi një platform prej betoni të varfer si në figurën e mëposhtme.



Ndriçimi

Ndriçuesit që do të përdoren janë:

a- Ndriçues shtylle me lartësi 4m.



b-

Ndriçues tek urat



Ndriçues për ambient os eorientues për ndriçimin e hapësirave publike.
Shkalla e mbrojtjes IP65.
Ndriçusei përbëhet nga alumin solid, vida çeliku inoks, plexiglass.

c- Ndriçues shirit LED



Shirit LED

Ngjyra - e Bardhe
Trupi - I pajisur me te gjitha aksesoret e nevojshem per funksionimin normal te shiritit LED

Per C.E.C GROUP.SH.P.K
Ing.Vangjush MBRICE